

**NË EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda,** duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, me antaret e trupit Sahit Boroci dhe Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi, duke vendosur ne ceshtjen penale te te akuzuarit A. Z. nga Gj., per shkak te vepres penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose shfrytezim te pautorizuar te armeve nga neni 328.par.1 te KPPK-se, e sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krimet e Renda PP. I.nr.146/ 2008 e dates 25.08.2016, e pas mbajtjes se séances gjyqesore me date 29.06.2016 shpalle kete:

**AKTGJYKIM**

Ndaj te pandehurit A. Z. nga babai R. dhe nena N., e lindur S., i lindur me date ..., ne fshatin K., k.V. , ka te kryer shkollën fillore, i martuar, baba i ... femive, punëtor sezonal, i gjendjes se varfër konomike, shqiptar, shtetas i Republikes se Kosoves.

**ËSHTË FAJTOR**

Me daten ... .2016, rreth orës ..., pa autorizim dhe ne kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka siguruar dhe mbajtur ne pronësi armeve e zjarrtë dhe ate ... “...”, me numër serik ... dhe ... karikator te zbrazur, e cila arme gjate bastisjes se shtepis se tij ne fshatin K., k V., nga zyrtaret policor te Policis se Kosoves, i eshte gjetur dhe konfiskuar.

Me cka ka kryer veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se.

-Andaj, ne baze te nenit 4, 41, 43, 46,49, 50, 51, 52, 69,73,74, 75 dhe 76 te KPRK, dhe nenit 365 dhe 450 te KPPRK-se.

## **E GJYKON**

Me denim gjobe ne shume prej 300.00( treqind ) euro, i cili denim nuk do te egzekutohet me kusht qe ne afat prej nje viti mos te perseris vepren penale.

**Detyrohet i akuzuari** qe kesaj gjykate ne emer te paushallit gjyqësor, ti paguaj shumen prej 10 euro, ndersa shpenzimet e procedures sipas llogarise perfundimtare te kesaj gjykate, te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh, nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

**Konfiskohet arma ..., me numer serik ...dhe ... karikator i zbrazur.**

## **ARSYETIM**

Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda, me date 13.05.2016, ka ngritur aktakuzen PP.I.nr.104/16 ndaj te akuzuarit F. D., per shkak te vepres penale mbajtje ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se.

Kryetari I trupit gjykues, me dt. 29.06.2016, ka mbajtur seancen fillestare, ne te cilen i pandehuri F. D., e ka pranuar ne tërsi vepren penale e cila i vehet ne barre ne baze te aktakuzes se Prokuroris Themelore DKR ne Gjilan, e ndien veten fajtor dhe ka kerkuar falje, duke cekur se ne te ardhmen nuk do te perseris vepra te tilla penale.

I njejti ka deklaruar se pranimin e fajsisë e ka bere ne menyre vullnetare dhe pa presion nga askush dhe se eshte i vetedijshem per pasojat e ketij pranimi si dhe ne konsulltim me avokatin e tij, R. A. .

**Prokurori i shtetit Arben Kadriu** , eshte pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e te pandehurit, duke konsideruar se pranimi fajsisë nga ana e e tij eshte e plote me provat qe gjenden ne shkresat e lendes, ndersa gjate marrjes se vendimit gjykata te kete parasysh rrethanat lehtesuese dhe renduese.

**Av. R. A.**, ka kerkuar nga Gjykata që me rastin e caktimit të denimit të merren parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë pranimit të fajësive nga ana e të mbrojturit të tij, i njëjti është penduar për veprën e kryer, gjendjen e tij skamnore dhe jeton nga ndihma sociale, si dhe sjellja e tij korrekte në këto seance. I propozon gjykatës që të shqiptoj një denim të kushtëzuar si dhe me denimin e këtill arrihet qëllimi i ndeshkimit të paraparë me dispozitën ligjore të kodit penal.

I akuzuari F. D. deklaron: e mbështet në tërësi fjalën e avokatit, pa ndryshim dhe plotësim dhe kërkon nga gjykata që mundësisht të shqiptojë një denim sa më të butë, sepse armen në fjalë pas luftës e ka gjete në oborr dhe të njëjten vetëm e ka ruajtur si souvenir, ndërsa nuk ka pas municion asnjeherë.

Gjykata pas pranimit të fajësive nga ana e të pandehurit dhe marrjes së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit si dhe nga mbrojtësi i të akuzuarit F. D., av. R. A., e ka aprovuar këtë pranim të fajësive, sepse ka konsideruar se është në pajtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi konfiskimin e armës dhe foto dokumentacioni.

Gjate matjes dhe shqiptimit të denimit, Gjykata ka patur parasysh sjelljen e mirë të të akuzuarit në gjykatë, pranimit të fajësive nga ana e tij pa asnjë hezitim, është penduar thellë për kryerjen e kesaj veprë, gjendjes së varfër ekonomike, shfrytëzues i ndihmës sociale, si dhe premtën se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku i akuzuari F. D., është shpallur fajtor dhe gjykuar me denim me gjobë në shumë prej 300.00 euro, të cilin nuk do ta paguaj me kusht që në afat prej një viti mos të perseris veprën penale.

**Te pandehurit F. D., i është konfiskuar arma ...**, me numer serik ...dhe ... karikator i zbratur, konform nenit 374 paragrafi 3, të KPRK-se. .

Gjykata të pandehurin e ka detyruar, që kesaj Gjykate t'ia paguaj shumën paushalle prej 10 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogaritëse perfundimtare të kesaj Gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**  
**Me date 29.06.2016**

**Sekretare Jurdike,**  
**Zahide Rexhepi**

**Kryetari I trupit:**  
**Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh, nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, e nepermes kesaj Gjykate.